

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika MonoTop®-109 WaterProofing

LLAÇ ÇIMENTOJE PËR HIDROIZOLIM TË LOKALIZUAR

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika MonoTop®-109 WaterProofing është llaç me një përbërës dhe bazë çimentoje me konsistencë që bën të mundur aplikimin me fuqë.

PËRDORIMET

Sika MonoTop®-109 WaterProofing është krijuar veçanërisht për projekte hidroizolimi me përmasë të menaxhueshme si p.sh. muret e bodrumeve, depozitat/ rezervuarët e vegjël dhe struktura nëntokësore.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Produkt prej 1 përbërësi, thjesht shtoni ujë
- Ndërkapje e mirë mbi nënshtresa të ndryshme
- Aplikim i lehtë dhe i shpejtë me fuqë
- I aplikueshëm direkt mbi tulla, beton dhe themele prej blloqesh guri

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Binder (element lidhës) çimentoje	
Ambalazhi	Qese alumini 5 kg e paketuar në kuti kartoni që përmban 4 copë	
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur gri	
Jetëgjatësia	15 muaj	
Kushtet e magazinimit	Të magazinohet saktë në ambalazhin e padëmtuar, të mbyllur dhe origjinal, në kushte të thata dhe të freskëta.	
Dendësia	Rifuxho	~1.25 kg/l
	Llaç i freskët	~2.10 kg/l

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	~0.5 MPa	(EN 1542)
Depërtimi i ujit nën presion	Pa depërtim uji (1.5 bar për 7 ditë)	(EN 14891, A.7)
Depërtimi i ujit nën presion negativ	Pa depërtim uji (2.50 bar për 72 orë)	(UNI 8298-8)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	1.25 litra uji për qese 5 kg (25 % ujë)
----------------------	---

Konsumimi	~1.5 kg / m ² për mm trashësie
Trashësia e shtresës	3 mm me trashësi konstante, të aplikuar min. në 2 shtresa
Temperatura e mjedisit	+5 °C minimum / +35 °C maximum
Temperatura e nënshtresës	+5 °C minimum / +35 °C maximum
Koha e punueshmërisë	~45 min në +20 °C
Koha e pritjes / mbiveshja	7 ditë (në +23 °C dhe 50 % lagështi relative) për shërbim të plotë

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër, pa pluhur, graso dhe grimca të lira. Fugat duhet të mbushen duke ekspozuar tullat ose blloqet e gurit. Përpara aplikimit, sipërfaqja duhet të laget plotësisht, duke shmangur grumbullimin e ujit. Mos aplikoni mbi gips, pllaka gipsi, llaçe anhidriti, dru, sipërfaqe të trajtuara me bojë, veshje, veshje plastike, bitum, sipërfaqe që rrjedhin ujë.

PËRZIERJA

Hidhni ujë në raportin e saktë brenda një konteineri për përzierje. Shtoni ngadalë pluhurin dhe përzierjen të paktën 3 minuta deri sa të arrihet një konsistencë homogjene.

APLIKIMI

Produkti mund të aplikohet me furçë me qime të ashpra, furçë ngjitësi, shpatull ose mallë të lëmuar në 2 ose 3 shtresa.

Për të siguruar depërtim dhe ngjitje të mirë mbi nënshtresë, shtresa e parë duhet të aplikohet me furçë.

Shtresa ose shtresat vijuese mund të aplikohen me furçë (shtresat vijuese duhet të aplikohen vertikalisht dhe horizontalisht) ose me shpatull kur e mëparshmeja është tharë mjaftueshëm (~ 4-6 orë) dhe jo më vonë se 12 orë. Në çdo rast, trashësia nuk duhet të kalojë 4 mm.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastrimi i veglave ose pajisjeve të aplikimit nga mbetjet e fresketa bëhet me ujë menjeherë pas përdorimit.

Materiali i ngurtësuar mund të pastrohet vetëm mekanikisht.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika MonoTop®-109 Waterproofing
Shkurt 2019, Botimi 01.01
020701010010000283

SikaMonoTop-109WaterProofing-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf